

LIGJ
Nr. 8327, datë 16.4.1998

**PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË
PËRCAKTUAR ME DEKRETIN NR.1838, DATË 25.7.1997, MIRATUAR ME LIGJIN
NR.8226, DATË 29.7.1997**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 35 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Struktura e Këshillit të Ministrave e përcaktuar me dekretin nr.1838, datë 25.7.1997, miratuar me ligjin nr.8226, datë 29.7.1997, ndryshohet si vijon:

1. Kryetari i Këshillit të Ministrave
2. Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave dhe ministër i Koordinimit Qeveritar
3. Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave dhe ministër i Pushtetit Lokal
4. Ministër i Punëve të Jashtme
5. Ministër i Mbrojtjes
6. Ministër i Rendit Publik
7. Ministër i Financave
8. Ministër i Punëve Publike e Privatizimit
9. Ministër i Drejtësisë
10. Ministër i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë
11. Ministër i Punëve Publike dhe Transportit
12. Ministër i Bujqësisë dhe Ushqimit
13. Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale
14. Ministër i Arsimit dhe Shkencës
15. Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
16. Ministër i Shëndetësisë
17. Ministër Shteti për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin Popullor
18. Sekretar Shteti për Integrimin European në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2048, datë 16.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani